



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 17i, datë 20.2.2023

PËR

**KRIJIMIN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS
PËR HARTIMIN E PROPOZIMEVE LIGJORE PËR PËRMIRËSIMIN
E CILËSISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE QË OFROHEN
NGA NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE, NËPËRMJET
SISTEMIT TË MATJES SË PERFORMANCËS SË SHËRBIMEVE
PUBLIKE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËR O J:

1. Krijimin e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e propozimeve ligjore për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike që ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet sistemit të matjes së performancës së shërbimeve publike.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme dhe të ketë në përbërje përfaqësues të nivelit të mesëm ose të lartë drejtues nga institucionet e mëposhtme:
 - Ministria e Financave dhe Ekonomisë, struktura përgjegjëse për çështjet e financave vendore; ✓
 - Ministria e Brendshme, struktura përgjegjëse për çështjet vendore; ✓
 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; ✓
 - Ministria e Arsimit dhe Sportit; ✓
 - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; ✓
 - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; ✓
 - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; ✓

- Ministria e Kulturës; -
- Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve; ✓
- Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët; ✓
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes; ✓
- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. ✓

3. Në grupin ndërinstitucional të punës ftohen të marrin pjesë në cilësinë e anëtarit edhe përfaqësues nga shoqatat e të zgjedhurve vendorë.
4. Në takimet e grupit ndërinstitucional të punës, me kërkesë të kryetarit dhe nëse vlerësohet e nevojshme, ftohen të marrin pjesë ekspertë të fushës, përfaqësues të institucioneve dhe të grupeve të interesit, përfshirë:
 - a) përfaqësues të bashkive dhe qarqeve;
 - b) përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile;
 - c) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare;
 - ç) ekspertë të tjerë vendas dhe ndërkombëtarë.
5. Anëtarët e grupit ndërinstitucional të punës, të caktuar nga institucionet përgjegjëse të përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, për aq sa është e mundur, të jenë përfaqësues të njësive përgjegjëse që monitorojnë veprimtarinë e organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe/ose mbikëqyrin funksionet e deleguara.
6. Grupi i punës ka këto detyra:
 - a) Analizon situatën aktuale në lidhje me performancën e ofrimit të shërbimeve publike në nivel vendor, me nivelin e zbatimit të legjislacionit përkatës dhe identifikimit të nevojave për ndryshime, shtesa ose akte normative të reja dhe harton raporte të vlerësimit të nevojave për këtë qëllim brenda 4 (katër) muajve nga miratimi i këtij urdhri;
 - b) Identifikon shërbimet publike me qëllim përmirësimin e cilësisë së ofrimit të tyre, propozon treguesit e matjes së performancës dhe metodologjinë për vendosjen e sistemit të administrimit të performancës nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke përfshirë si një nga çështjet e metodologjisë edhe mekanizmin e incentivave financiarë, brenda 8 (tetë) muajve nga miratimi i këtij urdhri;
 - c) Harton relacione apo raporte mbi analizën e kryer dhe propozon masa të tjera të nevojshme për vendosjen e sistemit të matjes së performancës së shërbimeve nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe i paraqet pranë ministrisë përgjegjëse, brenda 1 (një) viti nga miratimi i këtij urdhri;

- ç) Kryen çdo detyrë tjetër që caktohet nga kryetari i grupit të punës, në funksion të arritjes së qëllimit të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të institucionit që përfaqësojnë anëtarët e grupit të punës.
7. Grupi ndërinstytucional i punës të mbliidhet, si rregull, 1 (një) herë në muaj.
 8. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore të kryejë rolin e sekretariatit teknik, në mbështetje të veprimtarisë së grupit ndërinstytucional të punës.
 9. Sekretariati teknik i grupit ndërinstytucional të punës të përgatitë raporte dhe përditësime periodike, të paktën çdo 3 (tre) muaj, për institucionet që janë pjesë e grupit ndërinstytucional të punës.
 10. Kryetari i grupit të punës të informojë çdo 4 (katër) muaj për vijueshmërinë e procesit të punës titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2, të urdhrimit, si dhe t'i raportojë çdo 6 (gjashtë) muaj Kryeministrit.
 11. Titullarët e institucioneve, të përmendura në pikën 2, të caktojnë përfaqësuesit e institucionit të tyre dhe të njoftojnë në formë shkresore sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i këtij urdhri.
 12. Ngarkohen grupi ndërinstytucional i punës dhe sekretariati teknik për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

NR.PROT. 377/1
DATË 20.2. 2023

MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT
RURAL
MINISTRISË SË KULTURËS
MINISTRIT TË SHTETIT PËR STANDARDET E
SHËRBIMEVE
MINISTRIT TË SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT
MINISTRIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN E
SIPËRMARRJES
AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E
VETËQEVERISJES VENDORE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAJ

